



E ardhmja nis me ne!



# “HORIZON SCHOOL”

Njësia Lipjan



## KODI I MIRËSJELLJES

SHTATOR, 2023

Bazuar në Nenin 22 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikës e Kosovës dhe Udhëzimit Administrativ 06/2014 nga MASHTI, Këshilli Drejtues i Institucionit Privat të Arsimit Parauniversitar “Horizon School”, miratoi këtë rregullore për njësinë në Lipjan:

## KODI I MIRËSJELLJES

Disiplina dhe mirësjellja janë elementët kryesorë për një arsimim të mirë, kodi i mirësjelljes do t'i shërbej shkollës si një mekanizëm për mbarëvajtjen e procesit edukativo-arsimor, duke krijuar kushte dhe mundësi për zbatimin e rregullave të përcaktuara në këtë kod. Pa një atmosferë ku mbizotëron rregulli dhe disiplina, nuk mund të ketë mësimdhënie dhe mësim nxënie efektive. “HORIZON SCHOOL” është e përkushtuar që të ketë standardet më të larta të mirësjelljes në mbarë shkollën. Mirësjellja dhe konsiderata për të tjerët, bashkë me vetë disiplinën dhe respektin e duhur për autoritetet e shkollës, gjatë gjithë kohës inkurajohen të jenë pjesë e pandashme e shkollës. Ky dokument është hartuar duke u bazuar në standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe fëmijëve si dhe legjislacionin vendor. Ky kod i mirësjelljes i përcakton qartë rregullat e shkollës.

### Neni 1

#### Rregullat e përgjithshme

1. Të gjithë nxënësit, pa dallim, duhet të kenë sjellje të mira dhe të tregojnë respekt gjatë gjithë kohës ndaj njëri-tjetrit, stafit të shkollës dhe mësimdhënësve;
2. Shkolla duhet të mbahet e pastër dhe e rregulluar;
3. Nxënësit duhet të vijnë me kohë në shkollë dhe të jenë të përgatitur për mësim;
4. Nxënësit duhet të veshin uniformën shkollore gjatë gjithës kohës. Uniforma duhet të mbahet e rregulluar dhe e pastër;
5. Nxënësit nuk lejohen të përdorin dhe të mbajnë me vete telefonat mobilë dhe pajisje tjera elektronike (p.sh. Ipad, Ipod, etj) brenda objektit shkolle;
6. Të jetë i përgatitur për mësim dhe praktikë profesionale.

## Neni 2

### Rregullat në klasë

1. Nxënësit duhet të arrijnë me kohë dhe të jenë të pajisur me mjetet mësimore sipas udhëzimeve të mësimdhënësit;
2. Nxënësit duhet të mësojnë e punojnë me zell gjatë orarit mësimor;
3. Nxënësit duhet t'i respektojnë udhëzimet e drejtorisë dhe mësimdhënësve.

## Neni 3

### Rregullat në laboratorë

1. Nxënësit nuk lejohen të hyjnë në laboratorë pa lejen e mësimdhënësit;
2. Nxënësit duhet t'i dëgjojnë me kujdes udhëzimet e mësimdhënësit gjatë punës në laboratore;
3. Nxënësit nuk lejohen të vrapojnë nëpër laboratore;
4. Palltot dhe çantat duhet jenë nën bankë gjatë gjithë kohës sa nxënësit janë në laborator;
5. Nxënësve u ndalohet të prekin ndonjë enë me gaz, ujë apo ndonjë pajisje elektronike në laborator pa u udhëzuar nga mësimdhënësi;
6. Nxënësve u ndalohet ngrënia dhe pirja në laboratore.

## Neni 4

### Veprimet e ndaluara

1. Veprimet e dhunshme, si: kërcënimi, konflikti, vandalizimi, mosrespektimi, fyerja ndaj nxënësve dhe personelit;
2. Prishja e rendit dhe e qetësisë;
3. Lëshimi i orës së mësimimit pa lejen e mësimdhënësit;
4. Dëmtimi i inventarit dhe mjeteve të punës;
5. Mosardhja në shkollë (pa lejen e prindit);
6. Mos bërja e detyrave të shtëpisë;
7. Kopjimi / mashtrimi gjatë testit / provimit me shkrim dhe/ose me gojë;
8. Mosdëgjimi apo mos kushtimi i vëmendjes gjatë orës mësimore.

## Neni 5

### Vijueshmëria në mësim dhe praktikë profesionale dhe masat disiplinore

1. Nxënësi i cili mungon pa arsye 15 orë mësimi, i thyhet nota e sjelljes në 3;
2. Nxënësi i cili mungon pa arsye 25 orë mësimi i thyhet nota e sjelljes në 1;
3. Nxënësi i cili mungon pa arsye më shumë se 32 orë mësimi, pezullohet përkohësisht një deri në tre muaj nga procesi mësimor dhe vlerësohet mundësia për përjashtim /transferim në shkollë tjetër.

## Neni 6

### Masat edukativo-disiplinore që mund të merren ndaj nxënësit

1. Ndaj nxënësit mund të merren këto masa disiplinore:
  - a. Konfiskimi i gjërave të ndaluara në shkollë;
  - b. Vërejtje me gojë;
  - c. Vërejtje me shkrim;
  - d. Pezullim i përkohshëm nga garat, ekskursionet, vizitat, shëtitjet, etj.;
  - e. Pezullim i përkohshëm nga shkolla deri në 3 ditë;
  - f. Pezullim nga shkolla prej 1(një) deri në 3 (tre) muaj.

## Neni 7

### Vërejtjet

1. Vërejtja i shqiptohet nxënësit i cili bën shkelje të rregullave të shkollës, kompetent për shqiptimin e kësaj mase është kujdestari i klasës.

## Neni 8

### Vërejtjet me shkrim

1. Vërejtje me shkrim i shqiptohet nxënësit i cili i përsërit shkeljet e rregullave të shkollës. Këtë masë disiplinore e shqipton drejtori i shkollës me propozimin e kujdestarit të klasës.

## Neni 9

### Masa pezullim i përkohshëm nga aktivitetet jashtëshkollore

1. Pezullimi i përkohshëm nga aktivitetet jashtë shkollore si garat, ekskursionet, vizitat, shëtitjet, i shqiptohet nxënësit i cili me sjelljet e tij pengon aktivitetet jashtëshkollore.
2. Pezullimin nga aktivitetet jashtëshkollore me propozim të organizuesit të garës, e shqipton kujdestari i klasës.

## Neni 10

### Masa pezullim nga shkolla

1. Pezullim nga shkolla deri ne 3 (tre) ditë, i shqiptohet nxënësit i cili nuk përmirësohet edhe pas shqiptimit të vërejtjeve paraprake.
2. Masën e shqipton drejtori i shkollës me propozim të kujdestarit të klasës.

## Neni 11

### Pezullim nga shkolla nga 1(një) deri në 3 (tre) muaj

1. Pezullimi për 1 (një) muaj, i shqiptohet nxënësit i cili nuk përmirësohet edhe pas shqiptimit të masave paraprake.
2. Pezullimi prej 1 (një) deri në 3 (tre) muaj i shqiptohet nxënësit:
  - a. Nxënësit me sjellje te dhunshme apo agresive e cila nuk lejon vazhdimin e procesit edukativo-arsimor dhe aftësues të nxënësve tjerë;
  - b. Nxënësit që mungon mbi 32 orë mësimi pa arsye;
  - c. Moszbatimi i vendimeve të organeve të shkollës, si dhe rastet tjera që parashihen me rregullore të shkollës.

## Neni 12

### Procedura për zbatimin e masave

1. Iniciativën për të gjitha masat e merr kujdestari i klasës ose udhëheqësi i aktivitetit jashtëshkollor.
2. Për te gjitha masat e marra duhet të njoftohet prindi dhe të merren informatat kthyesë se prindi është në dijeni.
3. Njoftohet edhe nxënësi.
4. Të gjitha masat duhet të shënohen në ditar dhe në procesverbal.
5. Masat e shqiptuara me shkrim publikohen në tabelën për shpallje.

## Neni 13

### Mësimi alternativ

1. Drejtori i shkollës obligohet që ta njoftojë Këshillin Drejtues të shkollës për shqiptimin e masës sipas neni 11 dhe të kërkojë sigurimin e mësimi alternativ.
2. Këshilli Drejtues i shkollës është i obliguar që për nxënësit e pezulluar të sigurojë mësim alternativ.

## Neni 14

### E drejta në ankesë

1. Shkalla e parë – Drejtori i shkollës.
2. Shkalla e dytë – Këshilli drejtues i shkolles
3. Pala e pakënaqur me masat e shqiptuara ka të drejtën e ankesës në afat prej 3 ditësh pas marrjes se vendimit.
4. Organi kompetent, ankesën e shqyrton në afat prej 3 ditësh nga dita e pranimit të ankesës.
5. Ankesa kundër masës disiplinore të shqiptuar i bëhet organit kompetent të shkollës së dytë (Këshillit Drejtues të shkollës)
6. Ankesa e pezullon zbatimin e vendimit deri në vendimin e shkollës së dytë në përjashtim kur rrezikohet siguria e nxënësve.

## Neni 15

### Konfiskimi i gjërave të ndaluara në shkollë

1. Shkolla rezervon të drejtën për ta kontrolluar nxënësin, nëse dyshon që ai/ajo posedon gjëra të ndaluara, siç janë:
  - a. Armë të ftohta dhe të zjarrita;
  - b. Alkool;
  - c. Drogë;
  - d. Gjëra të vjedhura;
  - e. Cigare;
  - f. Imazhe pornografike.
  - g. Të tjera.

2. Gjatë kontrollimit, shkolla cakton 2 persona të personelit të shkollës – njëri person që kontrollon, dhe tjetri që shërben si dëshmitar gjatë kontrollimit. Kontrollimi duhet të bëhet nga personi që është i së njëjtës gjini me atë që kontrollohet.

### **Neni 16**

#### **Rregullat etike në punën arsimore dhe shkencore Detyrat profesionale në punën mësimore**

1. Të gjithë personat që veprojnë si mësimdhënës në Horizon School kanë këto detyra:
  - a. të përpiqen në arritjen dhe bartjen e nivelit të lartë të njohurive shkencore nga lënda (disiplina) e vet;
  - b. të garantojnë saktësinë, precizitetin, prezantimin e përmbajtjes së lëndës dhe pozicionin e duhur të lëndës brenda programit të studimeve;
  - c. t'i përpunojnë të gjitha temat në mënyrë të hapur dhe të ndershme;
  - d. t'i kontribuojnë zhvillimit intelektual të nxënësve brenda lamisë nga e cila zhvillohet mësimi;
  - e. t'u sigurojnë nxënësve vlerësim të punës së tyre që është publik i drejtë, objektiv dhe në kohë;
  - f. të garantojnë transparencë dhe publicitet të provimit si dhe objektivitet të notimit;
  - g. t'i respektojnë qëllimet arsimore, strategjitë dhe standardet e institucionit në të cilin ushtron veprimtari në interesin e zhvillimit të studentëve;
  - h. përmbajtja nga çfarëdo kushtëzimi për hyrje në provim me kushtet që nuk i përmbajnë plani dhe programi mësimor, e sidomos përmbajtja nga caktimi i kushteve të cilat arsimtarit i sjellin dobi ekonomike apo dobi të llojeve tjera;
  - i. marrja në konsideratë e mendimit dhe vlerësimit të nxënësve për kompetencën e tyre mësimore me qëllim të avancimit të kualitetit të procesit mësimor.

### **Neni 17**

#### **Hyrja në fuqi**

1. Ky Kod i mirësjelljes hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Kryetar i Këshillit Drejtues

---

Prof.Dr.Besim Beqaj